



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:258831
Datë: 18.04.2024
Numri i dokumentit: 05591816

C.nr.1270/2023

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri- Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses V.B nga V, të cilën e përfaqëson i autorizuari B.P, avokat seli në P, Rruga “U.H” nr..., Kompleksi R.S kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria e Arsimit, me seli në Vushtrri, me objekt kontesti kompensim për ushqim-shujta, për ditët e pranisë në punë, jashtë seance më datë 18.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia me numër C.nr.1270/2023, e datës 27.11.2023, e paditëses V.B, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, me objekt kontesti kompensimin e shpenzimeve të ushqimit-shujtave për ditët e kaluara në punë.

A r s y e t i m

Paditësja V.B me datë 27.11.2023, përmes avokatit B.P, ka ushtruar padi në këtë gjykatë kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë, me objekt kontesti për kompensimin për ushqim-shujta, për ditët e pranisë në punë.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë, ka vlerësuar se e njëjta nuk përmban kërkesë të qartë në petitumin e padisë pasi që nuk është përcaktuar saktë periudha kohore për të cilën paditësja kërkon kompensimin në emër të ushqimit-shujtave, si dhe nuk janë saktësuar ditët e kaluara në punë nga paditësja, ashtu që nuk i ka plotësuar kushtet e përmbajtjes së padisë në kuptim të nenit 253 të Ligjit 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK) që të veprohet sipas saj, kjo ngase kërkespadia e paditëses për kompensimin në emër të shujtave është drejtpëdrejtë e lidhur me numrin e ditëve të punës dhe periudhën kohore se kur janë realizuar ato ditë të punës.

Duke i hasur këto pengesa procedurale, kjo gjykatë me datë 01.03.2024, ka marrë aktvendim C.nr.1270/2023, me të cilin e ka obliguar paditësen që brenda tre (3) ditësh ta plotësoj padinë në mënyrë që të përcaktoj saktë periudhën kohore dhe ditët e punës së paditëses duke e paralajmëruar për pasojat e mos zbatimit të këtij vendimi të gjykatës siç janë përcaktuar me nenin 102.3 të LPK-së.

Sipas fletkthesës së postës për dorëzimin e shkresave, përfaqësuesi i paditëses avokati B.P e ka pranuar këtë aktvendim, e cila fletkthesë nga posta ka arritur në gjykatë me datë 07.03.2024

mirëpo edhe pse kanë kaluar më shumë së një muaj nga dita kur përfaqësuesi i paditëses e ka pranuar aktvendimin, i njejtë nuk ka vepruar sipas të njejtë.

Prandaj, duke u bazuar në nenin 102.3 të LPK-së, sipas të cilit thuhet se “*Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësia do të hidhet poshtë*”, gjykata mori vendim si në dispozitiv të këtij aktvendimi, me të cilin e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditëses sepse parashtrësia nuk i është kthyer gjykatës brenda afatit të përcaktuar me rastin e kthimit në plotësim të padisë.

Andaj, nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:258831, C.nr.1270/2023, me datë 18.04.2024**

G j y q t a r i

Leotrim Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi lejohet ankesa në afatin prej shtatë (7) ditësh, nga dita e marrjes së aktvendimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.